

## **Alro Sunrise Shpk**

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

---

### **1.Informacion i pergjithshem per shoqerine**

Shoqeria " Alro Sunrise " shpk eshte regjistruar prane QKR-se Tirane me 21/02/2018.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit nr . 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe shoqerite tegetare "i ndryshuar , nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi per tatimet dhe taksat .

Objekti i aktivitetit eshte: Import-eksport, shitje me pakice dhe shumice e mineraleve metalore dhe jo-metalore perfshire metalet e çmuara dhe gjysem te çmuara, kerkim, zbulim, eksplorim dhe shfrytezim i mineraleve ne quell te hapur dhe nentoke, perpunim dhe pasurim te mineraleve duke perfshire por pa u kufizuar ne: pluskim dhe ndarje e gravitetit, prodhim, derrmim, bluarje, pastrim, filtrim, ndarje, grupim, perqendrim i gravitetit, shkembim jonesh, ndarje e tretesit, perqendrim, ekstraktim elektrik, rafinim, shkrirje, pjkje, autoklave, ndarje e klorit dhe e mineraleve te papastra, kullim, kontenim, eksplorim dhe ekstraktim ne miniera dhe gurore, prodhim dhe perpunim i mineraleve dhe koncentrateve te tyre, shfrytezim dhe perpunim i mbetjeve te veprimitarise minerare, shpim, germim dhe spostim dhei per nxjerrjen e mineralit.

Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) : L81421009D

Kapitali themeltar I shoqerise :100,000 leke i ndare ne 3 kuota .

Kuotat e pronesise :

- Alexandru Liono zoterues I I kuote qe perben 51 % te kapitalit te regjistruar.
- Adriatik Hasa zoterues I I kuote qe perben 39% te kapitalit te regjistruar
- ASCOM INTERNATIONAL SRL zoterues I I kuote qe perben 10 % te kapitalit te regjistruar

Administrator I pergjithshem :Z. Alexandru Liono me te drejta te plota dhe detyra te percaktuara ne statutin e shoqerise ,me afat emerimi deri me 25-07-2023.

Forma Juridike e shoqerise :SH.P.K

Adresa kryesore e aktivitetit : TIRANE Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga Dora D'istria, Pallati Nr.3, Shkalla 2, Ap.1/2

Adresa sekondare : Lezhe Selite KURBNESH Njesia Administrative Selite,Zona Minerare Nr.358/1, Objekti Kurbnesh, Ish Fabrika e pasurimit te Bakrit Kurbnesh.

Shoqeria kryen aktivitetin e saj ne ambjent te marre me qera per zyre dhe aktivitetin minerar ne zonen minerare pajisur me nipt sekondar .

Numri i punonjesve me dt 31.12.2019 eshte 2 ndersa ne 31.12.2018 ka patur 2 punonjes.

Shoqeria eshte pajisur me lejen minerare te shfrytezimit nga QKB ne daten 30-12-2019 leje minerare me nr identifikimi 1884 miratuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë (M.E.I.).

### **2.PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL**

#### **Bazat e përgatitjes së pasqyrave**

Pasqyrat financiare jane përgatitur bazuar ne Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), te permiresuara publikuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit ne perputhje me ligjin 25/2018 date 10-05-2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare "dhe Vendimin e Keshillit te Ministrave per zbatimin e detyrueshem te SKK-ve.

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila eshte dhe monedha funksionale e shoqerisë.

Parimi i vijimesise: veprimitaria ekonomike e njesise sone raportuese nuk ka ne plan ose nuk do ta kete te nevojshme nderprerjen e aktivitetit te saj.



*flw*

## **Alro Sunrise Shpk**

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### **Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit ne datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humba nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare te paraqitura ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes se transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
EUR/ALL	121.77	123.42
USD/ALL	108.64	107.82

### **Instrumentat financiar**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme. Gjatë periudhës së raportuar nuk ka patur investime ne kapital apo instrumenta borxhi të përdorura gjatë aktivitetit. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimi me vlerën e drejtë rregulluar me kostot e transaksioni që lidhet me to, përvëc së përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njojjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten së përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parashë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

### **Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre**

Ne kete ze perfshihen mjetet monetare gjendje ne date 31-12-2019 ne llogarite rrjedhese prane bankave te nivelit te dyte dhe ne arke. Per njojjen fillestare te ketyre elementeve si dhe per gjendjet eshte perdonur politika kontabel e vleres nominale.

### **Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimi me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizoni per zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Veshtirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentoje ose riorganizimi financiar, dhe mospagesa apo kundravajtje ne pagesa (mbi 360 ditë vonesë) konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferenca midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parashikuara me normën efektive të interesit.

### **Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### **Hua të marra dhe të dhëna**

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimi me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njojjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njojur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferenca midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

### **Të tjera**

Instrumenta të tjera jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi

### **Inventaret**

Shoqeria nuk disponon gjendje inventari sepse nuk ka filluar aktivitetin e saj te shfrytezimit.



## **Alro Sunrise Shpk**

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Inventaret maten me vleren me te vogel midis kostos dhe vleres neto te realizueshme .Vlera neto e realizueshme eshte cimimi i vleresuar i shitjes ne rrjedhen normale te biznesit minus kostot e cmuara te perfundimit dhe kostot e cmuara qe duhen per realizimin e shitjes .

### **Aktive afatgjata materiale**

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumular dhe ndonje humbje te akumular nga zhvleresimi (nuk ka patur humbje nga zhvleresimi)

#### *(i) Njohja dhe matja*

Te gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumular. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialev dhe punës direkte, qdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit mbarten në "Ndërtim në proces" dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.Në rastet kur pjesë të një aktivit afat-gjata materiale kane jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

#### *(ii) Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përsitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### *(iii) Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jeten e vleresuar të cdo pjese të aktivit afat-gjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit për secilën kategori aktivesh afat-gjatë në periudhën aktuale janë si më poshtë:

○ Ndërtesa	Mbi vlerën kontabël neto	5%
○ Aktivet e patrupëzuara	Lineare	15%
○ Pajisje dhe programe IT	Mbi vlerën kontabël neto	25%
○ Të gjitha aktivet e tjera	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Metoda e amortizimit,jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo date raportimi.

Inventarin e Imet eshte llogaritur 15% e vleres.

### **Detyrimet Tatimore**

Ne kete grup perfshihen te gjitha llojet e tatimeve dhe taksave te llogaritura edhe te papaguara ndaj administrates tatimore te cilat vleresohen me vlerë nominale .Detyrimet tatimore afatshkurtra dhe afatgjata nuk skontohen dhe nuk zhvleresohen dhe llogariten ne Leke

### **Kapitali**

Kapitali i shoqerise perbehet nga kuotat e kapitalit ,kapitali njihet me vlerën nominale.

### **Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat perfaqesojne vleren e drejte te perfitimeve ekonomike te marra dhe ato qe jane per tu marre nga shitja e produktit te gatshem gjate aktivitetit te zakonshem te kompanise . Asnjë e ardhur nuk njihet nese ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove perkatëse.

### **Njohja e shpenzimeve**

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat gjate periudhes reportuese njihen ne te njejten periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese .Shpenzimet e kryera gjate një periudhe reportuese qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perfitime njesise



*Huse*

## **Alro Sunrise Shpk**

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(*...humat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe*)

ekonomike raportuese rregistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren perfitimet .Shpenzimet e ndodhura kur njesia ekonomike nuk pret perfitime te ardhshme ekonomike njihen menjehere ne rezultatin financia

### **7.Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazen e të drejtave dhe detyrimeve te konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare te mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### **8.Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatushme të vitit, duke përdorur normat tatile më miratuarat në datën e raportimit.

## **3 .SHENIMET SHPJEGUESE**

### **I Aktivet Aafatshkurtra**

#### **Shenimi nr 1 Mjetet Monetare 1,066,015 leke**

Vlera e mesiperme perfaqeson totalisht vleren e likuiditeteve ne daten 31-12-2019 gjendje qe shoqeria ka ne bankat te nivelit te dyte ne leke dhe valute si dhe gjendjen e arkes ne leke.Gjendja e likuiditeteve (ne banke)ne bilanc rakordon me shumen e ekstrateve neto te bankes.

#### **Arka dhe Banka**

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
<b>Arka</b>	37,313	16,863
Arka ne lek	37,313	16,863
Arka ne monedhe te huaj	-	-
<b>Banka</b>	1,028,702	2,338,543
Llogari rrjedhese ne banke ne Lek	6,004	2,007,987
Llogari rrjedhese ne banke ne monedhe te huaj	1,022,698	330,556
	<b>1,066,015</b>	<b>2,355,406</b>

#### **Shenimi nr 3 Te drejta te arketueshme**

Te drejtat te arketueshme perfaqesojnë tepricen kreditore te Tvsh dhe te tjera :

#### **Kliente dhe debitore te tjere**

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
TVSH	3,411,094	2,780,319
Debitore dhe kreditore tjere	2,495,630	
Te tjera tatime per tu paguar dhe per tu kthyer	3,821	3,821
	<b>5,910,545</b>	<b>2,784,140</b>



**Alro Sunrise Shpk**

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**Shenimi nr 5 Shpenzime te Shtyra**

Shoqeria nuk ka realizuar shitje, eshte ne faze investimi. Shpenzimet e kryera kane kaluar si shpenzime per tu shperndare ne periudhat te ardhshme:

**Shpenzime të shtyra**

	2,019	2,018
Shpenzime te 2018	1,679,751	
Qera zyre paradhenie muaji I fundit	43,729	43,729
Bl.energji,avull,uje	5,839	-
Qera zyre	367,827	174,572
Shpenzime per paga	-	411,691
Shpenzime per kontributet shoq& shend	166,608	98,188
Mirembajtje dhe riparime	-	150,292
Te tjera	653,719	125,228
Shpenzime per pritej dhe perfaqesime	-	320,000
Sherbime bankare	61,536	69,096
Tarife skanimi	-	8,301
Taksa vendore	12,500	11,458
 Tatime dhe taksa Garanci rehabilitimi,garanci investimi,tarifa per lejen mjedisore .	4,271,735	-
Gjoba dhe demshperblime	2,374	3,320
Amortizim I AQ afatgjate	0	472,019
Fitime nga kembimet valutore	(113,328)	(183,056)
Humbje nga kembimet valutore	23,297	18,642
 <b>7,175,587</b>	<b>1,723,480</b>	

**II Aktivet Afatgjata****Shenimi 8 dhe shenimi 10 AAM AAJM**

Aktivet afatgjata materiale jane prone e shoqerise , jane dokumentuar ne menyre te rregullt dhe priten perfitime nga perdomri i tyre ne te ardhmen .

	Investime ne proces	Escavator New Holland	Escavator VOLVO	Bulldozer Hanomag	Total AAM dhe AAJM
<b>AAM dhe AAJM neto me 31 Dhjetor 2018</b>	<b>500,000</b>	<b>3,040,038</b>	<b>1,866,278</b>	<b>1,701,952</b>	<b>7,108,269</b>
Kosto I Janar 2019	500,000	3,040,038	1,866,278	1,701,952	7,108,269
Shtesa 2019	-	-	-	-	-
Pakesime / Axhustime	-	-	-	-	-
<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>500,000</b>	<b>3,040,038</b>	<b>1,866,278</b>	<b>1,701,952</b>	<b>7,108,269</b>
 <b>AAM dhe AAJM neto me 31 Dhjetor 2019</b>	<b>500,000</b>	<b>3,040,038</b>	<b>1,866,278</b>	<b>1,701,952</b>	<b>7,108,269</b>

Vlera neto e AAM dhe AAJM ne daten 31-12-2019 eshte 7,108,269 leke .



**Alro Sunrise Shpk**

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**PASIVE****Shenimi 13 Detyrime Afatshkurtra**

Detyrimet afatshkurtra perfaqesojne detyrimet qe ka shoqeria per aktivitetin e shfrytezimit ,ndaj punonjesve, sigurimeve shoqerore dhe shendetesore si dhe te pagueshme ndaj detyrimeve tatumore detyrime te llogaritura ne muajin dhjetor 2019 dhe qe paguhen ne muajin Janar 2020. Te pagueshme ndaj ortaku perfaqesojne vlera te marra nga ortaku per nevojat e shoqerise.

**Furnitore dhe detyrime te tjera**

	2019	2018
Të pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	11,057,893	6,744,477
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	357,879	357,879
Të pagueshme ndaj sigurimeve shoqerore	41,652	38,448
Të pagueshme për detyrimet tatumore (tatum ne burim )	3,190	6,321
Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve dhe aksionereve	0	6,724,170
	<b>11,460,614</b>	<b>13,871,295</b>

**Shenimi 17 Detyrime Afatgjata**

Te pagueshme ndaj ortaku perfaqesojne vlera te marra nga ortaku per nevojat e shoqerise.

**Detyrime afatgjata**

	2019	2018
Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve dhe aksionereve	9,699,802	0
	<b>9,699,802</b>	<b>0</b>

**Shenimi 23 Kapitali**

## Kapitali aksioner

	2019	2018
Kapitali I nenshkruar	100,000	100,000
	<b>100,000</b>	<b>100,000</b>

**C Shënime të tjera shpjeguese**

Deri daten e mbylljes se pasqyrave financiare me date 09-0-2020 nuk ka patur ngjarje te cilat te ndikonin ne gjendjet e deklaruara nga shoqeria me 31-12-2019

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

( Emanuela Rustemaj )



Per Drejtimin e Njesise Ekonomike

( Alexandru LIONO )

